



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 29.05.2019

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.01.1995, “KODI PENAL I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR””(NISMË E 37 MIJË ZGJEDHËSVE)

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, në mbledhjen e datës 29 maj 2019.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin caktoi deputetin Besnik Baraj relator për shqyrtimin e këtij projektligji.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin propozuesit e nismës, përfaqësues të shoqatës “Animal Rescue Albania”.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, është një nismë e propozuar nga 37 mijë zgjedhës, e cila i paraqitet për shqyrtim Kuvendit, mbështetur në nenin 81 të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të cilësuar votash, prej tri të pestat, sipas nenit 81 të Kushtetutës.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Qëllimi i nismës së propozuar është ndryshimi i Kodit Penal dhe shtimi në të i një kreu të ri, kreu XII, i titulluar “Veprat penale kundër mirëqenies së kafshëve”, nismë kjo e iniciuar me nënshkrime të 37 500 qytetarëve me të drejtë vote, konform nenit 81 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Nisma propozon shtimin e kreut XII “ Vepra penale kundër mirëqenies së kafshëve” , i përbërë nga 6 nene:

Neni 1 parashikon dënime me burg nga gjashtë muaj deri në dy vite për cilindo që me ligësi apo pa arsye vret një kafshë.

Neni 2 parashikon dënime me gjobe dhe me burgim për cilindo që pa arsye të ligjshme i braktis apo i keqtrajton kafshët.

Neni 3 parashikon dënim me gjobë dhe burgim për cilindo që promovon, organizon apo drejton ndeshje ndërmjet kafshëve duke i shkaktuar vuajtje apo tortura.

Neni 4, parashikon dënim me gjobë dhe burgim për cilindo që kryen eksperimente me kafshët.

Neni 5 parashikon dënim me gjobë dhe burgim për cilindo që përdor lëkurën e kafshëve të shoqërimin dhe individëve të faunës së egër në rrezik zhdukje. Neni 6 i projektligjit parashikon dënim me gjobë dhe burgim për cilindo që vret dhe robëron individët e faunës së egër në rrezik zhdukjeje.

Këto dispozita që propozohet të shtohen përfaqësojnë figura ose shfaqje të ndryshme të kryerjes së veprimeve të dhunshme ndaj kafshëve dhe propozohet të përfshihen në Kodin Penal si vepra penale dhe jo kundërvajtje penale.

- ***Diskutimi në Komision***

Në prezantimin e nismës, propozuesit shprehën qëllimin e hartimit të kësaj nisme, e cila ka ardhur si rezultat i ngjarjeve të kohëve të fundit, të bëra publike edhe në media, lidhur me dhunimin e kafshëve, veçanërisht të qenëve endacakë dhe mbajtjen e tyre, p.sh, arinjve, shqiponjave, etj, në kushte shumë të këqija hijeno sanitare.

Modeli në të cilin janë bazuar propozuesit për hartimin e nismës është ai i Republikës së Kosovës, e cila ka miratuar së fundmi shtimin e disa dispozitave në Kodin Penal , të cilat parashikojnë masa për veprat penale të dhunës ndaj kafshëve. Modele të tilla ekzistojnë edhe në vende të tjera të BE-së, të cilat kanë të parashikuar në Kushtetutë, në Ligjin Penal apo në ligje të posaçme, dispozita për mbrojtjen e kafshëve.

Relatori, deputeti Besnik Baraj, vlerësoi nismën e propozuar, për vet faktin se nisma të tilla nuk janë shumë të shpeshta, duke qenë se prevalojnë nismat e propozuara nga qeveria apo deputetët, por edhe për shkak të ndjeshmërisë që përcjell tema e mbrojtjes së kafshëve dhe nevojës që ka shoqëria shqiptare për t’u edukuar lidhur me mënyrën e mbajtjes dhe trajtimin e kafshëve.

Gjithashtu, relatori evidentoi edhe vështirësinë që kanë pasur hartuesit për paraqitjen e saj në formën e një projektligji, edhe për faktin se mungon një ligj për detajimin e mënyrës së ushtrimit të iniciativës ligjvënëse të shtetasve, e drejtë kjo e sanksionuar në nenin 81 të Kushtetutës.

Nga ana tjetër relatori evidentoi edhe disa problematika që paraqet nisma e propozuar:

Së pari, ajo çka vërehet në nismën e paraqitur në formën e një projektligji, është fakti se hartuesit propozojnë shtimin e 6 dispozitave të reja në kreun XII “ Vepra penale kundër mirëqenies së kafshëve”, të cilat propozohen si krime dhe asnjëra prej tyre si kundërvajtje penale, duke u shoqëruar me masa dënimi të rënda, të cilat ndoshta i tejkalojnë edhe ato të dënimeve për vepra të tjera penale, edhe më të rënda, të parashikuara në Kodin Penal.

Për këtë arsye, ai sugjeroi rishikimin e penaliteteve në projektligj, duke mbajtur parasysh edhe parimin e proporcionalitetit, duke vendosur mjetin e zgjedhur për ndëshkimin e shkelësve të ligjit në raport me qëllimin që kërkohet të arrihet.

Së dyti, nëse i referohemi legjislacionit të brendshëm, konstatojmë se në ligje të ndryshme janë të parashikuara dispozita që garantojnë mirëqenien e kafshëve, ndërkohë që në Kodin Penal mungojnë dispozita të cilat parashikojnë vepra penale me qëllim mbrojtjen dhe garantimin e jetës dhe shëndetit të njerëzve nga kafshët e shoqërimin, ashtu edhe për shëndetin publik nga sëmundje të transmetueshme nga kafshët.

Së treti, në aspektin formal, nisma nuk është e hartuar në formën e një projektligji dhe nuk shoqërohet nga një relacion shpjegues, sipas përcaktimeve të nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

- **Përfundim:**

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni miratoi në parim, me shumicë votash, nismën e propozuar, por, me qëllim sjelljen e saj në formën e duhur ligjore, në përputhje dhe me frymën e Kodit Penal, i sugjeron komisionit përgjegjës, që :

- Në aspektin formal nisma e propozuar nga 37 mijë zgjedhës të bashkohet me nismën ligjore të propozuar nga një grup deputetësh të Partisë Socialiste, për ndryshime në Kodin Penal, me qëllim miratimin njëkohësisht të tyre, si dhe të bëhen ndryshime në aspektin e teknikës legjislative, për ta sjellë atë në formën e një projektligji ;
- Në aspektin përmbajtësor, nisma të ripunohet, duke rishikuar masat e dënimeve për veprat penale, bazuar në parimin e proporcionalitetit, si dhe të plotësohet edhe me dispozita të cilat të parashikojnë vepra penale të tjera, të cilat do të garantonin edhe mbrojtjen dhe garantimin e jetës dhe shëndetit të njerëzve nga kafshët e shoqërimin, ashtu edhe për shëndetin publik nga sëmundje të transmetueshme nga kafshët.

RELATOR

KRYETAR

Besnik BARAJ

Niko PELESHI